



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 490/2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, në tekstin e mëtejshëm “PZAP” në panelin e përbërë nga Shukri Sylejmani, kryesues, Ymer Hoxha, Muharrem Shala, Muhamet Rexha, Ferit Osmani, Vllastimir Dimić, Xhevdet Abazi, Hasan Shala, Rafet Haxhaj dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e parashtruara për parregullsitë në procesin e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të paraqitura nga subjektet politike: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Rrjeti Ballkanik i Gazetarëve Hulumtues (BIRN), në seancën e mbajtur më 16.12.2010, mori këtë;

**V E N D I M**

**I. PRANOHEN** të bazuara ankesat për komunat: Skenderaj, Drenas, Deçan, Malishevë dhe Lipjan dhe atë me numrat si vijon: A. nr. 490; 528; 542; 563; 554 ; 555; 557; 561; 562; 563; 564; 566; 570, 574; 580; 581; 593; 595; 596; 597; 599; 601; dhe 604, ashtu që **ANULOHEN** rezultatet zgjedhore dhe **URDHËROHET** Komisioni Qendror Zgjedhor (**KQZ**) të përsëris votimin në komunat e lartë cekura.

**II.** Për komunën e Skenderajt në vendvotimet si vijon:

- a) 2101b/01, 2101b/02, 2101b/03 dhe 2101b/04,
- b) 2101x/01, 2101x/02, 2101x/03 dhe 2101x/04,
- c) 2102b/01 dhe 2101b/02,
- d) 2105b/01, 2105b/02, 2105b/03 dhe 2105b/04,
- e) 2106b/01, 2106b/02, 2106b/03 dhe 2106b/04,
- f) 2110b/01, dhe 2110b/02,
- g) 2112b/01, dhe 2112b/02,
- h) 2115b/01, dhe 2115b/03,
- i) 2116b/01, dhe 2116b/02,
- j) 2117b/02,
- k) 2129b/01,
- l) 2130b/01, dhe 2130b/02.

**III.** Për komunën e Drenasit në vendvotimet si vijon:

- a) 0301e/01 dhe 0301e/05,
- b) 0309e/01 dhe 0309e/02,

- c) 0310e/01, 0310e/02, 0310e/03 dhe 0310e/04,
- d) 0314e/01 dhe 0314e/02,
- e) 0316e/03.

**IV.** Për komunën e Deçanit në vendvotimet si vijon:

- a) 0101x/01, 0101x/04, 0101x/06 dhe 0101x/07.
- b) 0108c/06.

**V.** Për komunën e Malishevës në vendvotimet si vijon:

- a) 3008a/01 dhe 3008a/03,

**VI.** Për komunën e Lipjanit në vendvotimet si vijon:

- a) 1304e/01

I urdhërohet KQZ-së që:

- Të bëj ndërrimin e Komisionarëve të Qendrave të Votimit dhe:
- Të shtoj mbikëqyrjen gjatë procesit të rivotimit.

## A r s y e t i m

Pas ditës së zgjedhjeve parlamentare të parakohshme të mbajtura me dt. 12 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar ankesa nga subjektet politike saktësisht të theksuara në hyrje të këtij vendimi lidhur me mashtrimet, pa rregullsitë dhe gabimet tjera gjatë procesit zgjedhor me rastin e votimit dhe numërimit në qendra të votimit dhe vendvotime të ndryshme në komunën e Skenderajt, Drenasit, Deçanit, Malishevës dhe Lipjanit.

Parashtruesit e ankesave në ankesat e tyre kanë cekur se në shumë vendvotime ka pasur vjedhje votash, blerje të komisionarëve, falsifikime të nënshkrimeve, procesverbaleve, mbushje të kutive të votimit në mënyrë të pa rregullt, votime familjare, presione dhe shantazhe etj. Kështu, subjektet politike të theksuara saktësisht në dispozitiv të vendimit pretendojnë për parregullsi të kryera në qendrat dhe në vendvotime me propozim që PZAP-i t'i anulon rezultatet e votimeve në këto qendra dhe vendvotime si dhe të urdhëroj KQZ-në të përsërisë votimin në këto qendra të votimit dhe në vendvotime për shkak se kanë pasur ndikim në rezultatet finale.

Me qëllim të ekonomizimit dhe efikasitetit të punës në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurës të PZAP-it, Paneli ka vendosur ti bashkon ankesat e parashtruara të cilat kanë përmbajtje të ngjashme, ashtu që Paneli të gjitha ankesat e parashtruara i ka shqyrtuar dhe ka marrë vetëm një vendim.

PZAP-i në bazë të nenit 117.2 të Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/L-256) të datës 29 tetor 2010 i ka shqyrtuar dhe hetuar pretendimet ankimore, provat që gjinden në shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të secilës provë veç e veç e në lidhshmërinë e tyre reciproke si dhe duke u bazuar në rezultatin e tërësishëm të provave të administruara, ka gjetur se:

## Ankesat janë të bazuara

Në bazë të nenit 115.1 të LZP në Republikën e Kosovës, saktësisht parashihet se PZAP-i është organi i përhershëm i pavarur dhe ka kompetencë për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet të cilat kanë të bëjnë me procesin zgjedhor. Nga kjo dispozitë qartë rrjedhë se PZAP-i ka kompetencë për të vendosur vetëm përkitazi me ankesat dhe apelet që i referohen procesit zgjedhor, kështu që PZAP-i nuk ka kompetencë që në bazë të detyrës zyrtare të shqyrton dhe vlerëson procesin zgjedhor lidhur me të cilin nuk është paraqitur ankesë ose apel.

Në bazë të nenit 106.2 të LZP-së saktësisht parashihet se KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave para certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve në çdo vendvotim, qendër të numërimit, ose edhe të urdhëroj përsëritjen e votimit në një qendër të votimit apo në një komunë. Në bazë të kësaj dispozite qartë është përcaktuar kompetenca e KQZ-së që para certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të urdhëroj rinumërimin e votave ose përsëritjen e votimit në një qendër votimi apo në një komunë. Në bazë të këtyre dispozitave në mënyrë të sigurt dhe të qartë janë përcaktuar kompetencat e PZAP-it dhe KQZ-së.

Nga provat në shkresa të lendes dhe nga rezultati i hetimit të kryer nga paneli i PZAP-it, e pas analizimit dhe vlerësimit të gjithanshëm të provave, PZAP-i vërtetoi këtë gjendje faktike:

Në bazë të raportit të hetuesve të angazhuar nga PZAP-i, të cilët kanë përcjellur dhe hetuar parregullsitë e theksuara në ankesat e cekura më lartë, nga shikimi dhe vlerësimi i Listës Përfundimtare të Votuesve (LPV) dhe Librave të vendvotimeve, konstatimi i fakteve të mashtrimit, hetimet në analizën e nënshkrimeve në LPV dhe Formularin e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve si dhe nga kontrolli i FPR-ve dhe nga fotokopjimet e materialeve relevante, lidhur me parregullsitë e pretenduara janë konstatuar parregullsi që i referohen nënshkrimit nga ana e një personi për shumë votues, nënshkrimi i një kryefamiljari për të gjitha anëtarët e familjes për shkak se ky nënshkrim në listën e votuesve qartë vërehet se është nënshkrim i të njëjtit person, apo për personin e moshuar i lindur në vitin 1911, 1916, 1917, 1920, etj. për të cilët është nënshkruar personi tjetër, përdorimi i shpeshtë vetëm i inicialeve me shkronja të mëdha në vend të nënshkrimit, shumëfishimi i nënshkrimeve të cilat kanë të njëjtin dorëshkrim, nënshkrime të bazuara vetëm në emër dhe mbiemër të votuesit të shqiptuara në mënyrë të gabuar.

Sa për ilustrim përkitazi me komunën e Skenderajt potencohet fakti se këto falsifikime janë bërë në qendër të votimit si vijon:

- 2101b/01, të falsifikuara 563, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2101b/02, të falsifikuara 321, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2101b/03, të falsifikuara 232, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2101b/04, të falsifikuara 281, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2101x/01, të falsifikuara 358, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2101x/02, të falsifikuara 180, nënshkrime, respektivisht vota,
  
- 2101x/03, të falsifikuara 375, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2101x/04, të falsifikuara 399, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2102b/01 të falsifikuara 294, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2101b/02, të falsifikuara 268, nënshkrime, respektivisht vota,

- 2105b/01, të falsifikuara 340, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2105b/02, të falsifikuara 291, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2105b/03, të falsifikuara 300, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2105b/04, të falsifikuara 237, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2106b/01, të falsifikuara 158, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2106b/02, të falsifikuara 323, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2106b/03, të falsifikuara 403, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2106b/04, të falsifikuara 97, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2110b/01, të falsifikuara 779, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2110b/02, të falsifikuara 223, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2112b/01, të falsifikuara 432, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2112b/02, të falsifikuara 403, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2115b/01, të falsifikuara 216, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2115b/03, të falsifikuara 321, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2116b/01, të falsifikuara 400, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2116b/02, të falsifikuara 279, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2117b/01, të falsifikuara 297, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2117b/02, të falsifikuara 253, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2129b/01, të falsifikuara 150, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2130b/01, të falsifikuara 189, nënshkrime, respektivisht vota,
- 2130b/02 të falsifikuara 196, nënshkrime, respektivisht vota.

Parregullsi të ngjashme në qendrat e votimit, respektivisht vendvotimit janë konstatuar në komunën e Drenasit, në komunën e Deçanit, në komunën e Malishevës dhe në komunën e Lipjanit e lidhur me këto fakte ka prova të mjaftueshme në shkresat e lëndës. Këto parregullsi të nënshkrimeve përfaqësojnë shkelje të përcaktuara me nenin 91.2 të LZP dhe se kjo shkelje përbën vepër penale dhe është e dënueshme sipas Kodit Penal të Kosovës. Në bazë të rregullave zgjedhore të KQZ-së 9/2009 - neni 11.4 është paraparë se nëse emri dhe mbiemri i votuesit gjendet në LPV pa një shenjë ose shënim, votuesi duhet të udhëzohet të nënshkruhet në LPV pranë emrit të tij apo të sajë. Gjatë hetimit është konstatuar shkelja e kësaj rregulle zgjedhore duke përfshirë disa kategori të nënshkrimeve të parregullta si: shumëfishimi i nënshkrimeve të cilat kanë të njëjtin dorëshkrim, nënshkrime të bazuara vetëm në emër dhe mbiemër të votuesit të shqiptuara në mënyrë të gabuar, përdorimi shumë shpesh vetëm i inicialeve apo shkronjave të mëdha në vend të nënshkrimit.

Në disa qendra të votimit është konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 15.4.e të Rregullës Zgjedhore 9/2009 që ka ë bëjë më procesin e numrit në vendvotime të rregullta, sipas së cilës, në prani të kryesuesit të ekipit të numërimit, anëtarët e ekipit të votimit duhet të nënshkruajnë FPR-të para dorëzimit të gjithë formularëve, materialin dhe kutitë e mbyllura të votimit tek ekipi i numërimit, ashtu që pastaj ekipi i votimit do të lëshojë VV, pas dorëzimit.

Është vlerësim i panelit të PZAP-it se në rastin konkret zgjedhja me e drejtë për ti evituar parregullsitë e evidentuara më lartë është që të anulohen rezultatet zgjedhore të theksuara sikurse në dispozitiv të vendimit dhe ti urdhërohet KQZ-së që në këto qendra të votimit, respektivisht vend votimit të përsërisë votimin në komunën e Skenderajt, Drenasit, Deçanit, Malishevës dhe Lipjanit për arsye se PZAP-i vlerëson se këto parregullsi, respektivisht falsifikime kanë pasur ndikim relevantë lidhur me rezultatet finale.

Me qëllim që zgjedhjet të jenë fer dhe demokratike si dhe të evitohen parregullësitë dhe dilemat eventuale, janë anuluar rezultatet zgjedhore dhe i është urdhëruar KQZ-së, që të përsërisë votimin sikurse qëndron në dispozitiv të vendimit.

Nga të cekurat është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi e në bazë të neneve: 115.1, 117.2, 117.3, dhe 120.1 nën pikën b). të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/L-256) të datës 29 tetor 2010).

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 490/2010 me datë 16.12.2010



Kryesuesi i Panelit  
Shukri Sylejmani